

25341

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. Akt 25341

**VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK**

Sot, me date 2 Mars 2001, une *Replek Pajon* gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe Vendimin e Mbledhjes se Pergjithshme te Jashtezakonshme te Shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SH.K.K shoqeri e cila eshte ne procesin e transformimit ne shoqeri anonime, dokumente te cilat mu paraqiten nga z. Roland Bagaviki ne cilesine e personit te autorizuar nga Mbledhja e Pergjithshme e Jashtezakonshme e Shoqerise e dates 19 Tetor 2000.

KONSTATOVA:

Se shoqeria "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" sh.k.k eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Tiranes me Vendim Nr. 4572 dhe Nr.6246 date 30 Dhjetor 1998 ne baze te ligjit 8089 date 21 Mars 1996 "Per Shoqerite Kursim Kredi". Ortaket themelues te saj jane: Roland Bagaviki, Kaila Musha, Donika Kercini, Mishel Remarcka, Ariana Haxhiu, Mark Crawford, John De lanoy Lewis dhe William Reichardt. Selia e shoqerise eshte ne adresen Rruga "Thanas Ziko" N.25/1, Tirane.

Me date 19 Tetor 2000, eshte mbajtur Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Pergjithshme ne te cilen eshte marre vendim per te shendruar shoqerine ne nje shoqeri anonime me te njejtet aksionere dhe per kete qellim eshte caktuar eksperti kontabel i miratuar z. Ilirjan Hoxha i cili ka bere vleresimin e aktiveve te shoqerise, aktive te cilat do te sherbejne si te tilla te shoqerise anonime.

Me date 20 /02/2001, Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Pergjithshme ka marre vendim per :

1. Miratimin e Raportit te Vleresimit te aktiveve te shoqerise te pergatitur nga Eksperti Kontabel i Miratuar;
2. Shfuqizimin e Statutit te vjeter te shoqerise kursim krediti;
3. Miratimin e Statutit dhe Aktit te ri te themelimit te shoqerise anonime;
4. Klaimin e te gjitha te drejtave dhe detyrimeve shoqerise se transformuar.
5. Emerimin e anetareve te organeve te reja te shoqerise si me poshte:

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 anetare te cilet jane:

Roland Bagaviki (Kryetar)
William Reichardt (anetar)
Donika Kercini (anetare)

Drejtoria perbehet nga 1 anetar qe eshte Drejtori I Pergjithshem z. Richard Halmekangas.

6. Ndryshimi i selise nga Rruga "Thanas Ziko" N.25/1 do te jete ne Rruga "Gjin Bue Shpata" N.7/1, Tirane.
7. Futjen si kapital themeltar te shoqerise vetem pjesen prej 2.000.000 leke nga totali i pergjithshem i aktiveve te vleresuar ne shumen 241.870.920,53 leke qe perben kapital ne natyr dhe kapital ne para.
8. Emertimi i shoqerise se transformuar do te jete "Partneri Shqiptar ne Mikro kredi" Sh.a.

PER KETO ARSYE:

Bazuar ne sa me siper si dhe ne Ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe ligjin Nr. 8089, date 21.03.1996 "Per Shoqerite Kusim Kredi":

VENDOSA:

1. Pranimin e kerkeses per shendrimin e shoqerise nga forma kursim-kredi ne formen e shoqerise anonime
2. Depozitimin e Vendimit te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikro kredi" Sh.a.
3. Depozitimin e Statutit dhe Aktit te ri te themelimit te shoqerise anonime; Aksioneret e Shoqerise do te jene Roland Bagaviki, Kaila Musha, Donika Kercini, Mishel Remarcka, Ariana Haxhiu, Mark Crawford, John De la noy Lewis dhe William Reichardt.
4. Selia e shoqerise do te jete ne adresen Rruga "Thanas Ziko" N.25/1, Tirane.
5. Kpitali I Shoqerise eshte 2.000.000 leke.
6. Kohezgjatja e Shoqerise eshte 50 vjet.
7. Drejtori I Pergjithshem eshte z. Richard Halemkangas
8. Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise
9. Regjistrimin ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare te shoqerise anonime me nje numer te ri regjistrimi.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

Gjyqtare

Regleta Panajoti

